

# AKTI I THEMELIMIT

## I SHOQERISE " INA " sh.p.k



### Neni 1

Me vullnetin e ortakut te vetem  
INA BEBIU i datelindjes 03.03.1975 lindur dhe banuese  
ne Vlore  
themelohet Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar " INA "  
Sh.P.K.

### Neni 2

Shoqeria do ta kete qendren e saj me qytetin e Vlores ne  
Lagjen " Pavarsia" N. 1070  
Me vendim te Ortakut te vetem dhe sipas parashikimeve ne  
Statut mund te hapen edhe qendra te dyta sekondare sipas  
nevojave te Shoqerise.

### Neni 3

Kohezgjatja e Shoqerise do te jete jo me pak se 10  
vjet.  
Shoqeria mund te zgjase aftin minimal sipas parashikimeve  
ne statut ose edhe mbun te mbyllet edhe para ketij afati  
sipas parashikimeve ne statut.

### Neni 4

Shoqeria ka si Objekt te veprimaterise se saj :  
Import-Export  
Tregeti me shumice te artikujve te ndryshem industriale  
dhe ushqimore, materiale te ndryshme ndertimi dhe  
hidrosanitare , elektrike, elektronike,  
elektroshtepiake, tekstile, galanteri, prodhime kozmetike,  
dhe detergjente, veprimtari ne fushen e sherbimeve, ne  
fushen e arsimit jpublik , kurseve te gjuheve te  
huaja, informatikes etj , trasporteve te mallrave dhe  
udhetareve, hapje restorantesh e bare.

### Neni 5

Kapitali themelor i kesaj firme eshte i perbere prej  
kapital financiar ne shumen prej 100.000 njeqind mije  
lekesh i depozituar ne Banke ne emer te Shoqerise dhe  
zoterohet i tere prej Ortakut te vetem INA NEBIU

Kapitali eshte i ndare ne 100 kuota me vlere sejcila  
prej 1000 leke .Te gjitha kuotat e ketij kapitali  
zoterohen prej Ortakut te vetem

Ortaku ka te drejte te shtoje kuotat e ketij kapitali apo ti tjetersoje ato ne persona te trete sipas parashikimeve ne Statut.

Neni 6

Administrator i kesaj Shoqerie do te jete Ortaku i vetem INA NEBIU

Kopetencat e tij jane te percaktuara ne Statutin e kesaj Shoqerie.

Neni 7

Cjithe veprimataria e kesaj Shoqerie do te bazohet ne statutin e saj, ne Ligjin N. 7638 date 19.11.1992 "Per shqoerite tregtare " dhe ne legjislacionit shqiptar ne teresi dhe sipas Statutit te saj.

THEMELUESI

INA NEBIU





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA 170

Vlore me 20.11.2000

V E R T E T I M

Sot me 20.11.2000 para meje noteres u paraqit personalisht shtetasia INA NEBIU e datelindjes 03.03.1975 lindur dhe banuese ne Vlore .  
Madhor me zotesi te plote per te vepruar i pa njohur prej meje per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te ligjit nga pasaporta e saj me Nr. 1755030 e cila me vullnetin e saj nenshkroi para meje Aktin e Themelimit te Sh.P.K. " INA "  
Une noterja e legalizoj aktin si te rregullt ligjerisht.

NOTERE  
ALMA MUSARAJ



# STATUT

## I SHOQERISE " INA " SH.P.K.



PALET ,FORMA,BAZA JURIDIKE,SELIA

Neni 1.

Eshte themeluar nje Shoqeri tregtare private " INA " Sh.p.k. nga Ortaku i vetem

1.INA NEBIU datelindjes 03.03.1954 lindur dhe banuese ne Vlore

Neni 2.

Shoqeria formohet konform legjislacionit shqiptar dhe si Person Juridik fillon aktivitetin e saj menjehere pas rregjistrimit ne regjistrin tregetar ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

Neni 3

Shoqeria e ka seline e saj ne qytetin e Vlores ne Lagjen "Pavarsia " N.107) Rruga Sadik Zotaj Me vendim unanim te Oratkut te vetem Shoqeria mund te ndertoje qendra te dyta ose filiale ne vende te tjera.

Neni 4

Vendimet qe kane lidhje me veprimatrine e kesaj shoqerie do te merren prej Ortakut te vetem INA NEBIU .Po ashtu dhe fitimi i realizuar do ti takoje vetem atij.

Neni 5

Aktiviteti i shoqerise ,si nga ana e veprimatrise ekonomike ashtu dhe nga ana operative do te regjistrohet ne nje Liber te posacem qe quhet Libri i Shoqerise.

Neni 6

Kohezgjatja e veprimatrise se shoqerise eshte caktuar per 10 vjet por me vendim te ortakut ky afat mund te zgjatet ose Shoqeria mund te shkrihet para kohe sipas parashikimeve ne statut.

Neni 7

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

Import-Export .

Tregetimin me shumice te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore,materialeve te ndryshme te ndertimit dhe hidrosanitare , elektrike, elektronike, elektroshtepiake,tekstile,galantare,bizhuteri,prodhime kimike dhe detergjente,veprimtari ne fushen e sherbimeve veprimtari ne fushen e arsimit jopublik , hapjen e

kurseve per gjuhe te huaja, informatike etj, trasporteve te mallrave dhe udhetareve , hapje restrantesh e baresh. Shoqeria ka te drejte gjithashtu te kryeje veprimtari, dhe te bashkepunoje me shoqeri te tjera me objekt te njejte ose te ngjashem me te.

#### Neni 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 njeqind mije leke i gjithe kapital financiar i depozituar ne Banke dhe zoterohet prej ortakut te vetem .

Ky kapital eshte teresisht i shlyeshem nga Ortaku.

Shoqeria mund ta shtoje ose ta pakesoje kapitalin e saj me miratim te Ortakut te vetem.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 kuota me vlere sejcila prej 1000 lekesh.

Kuotat e ketij kapitali zoterohen prej Ortakut te vetem

#### Neni 9

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te trasferueshme

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu trasferohen te treteve vetem me vendim te Ortakut

Pjeset e kapitalit jene te trasferueshme tek trashegimtarete ne rast vdekje apo invaliditeti te pakthyeshme qe ben te pamundur ushtrimin e te drejtave te detyrimeve te Ortakut.

#### Neni 10

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve Asambleja mund te jete e zakoneshme ose e jashtezakoneshme sipas ligjit.

Asambleja e zakoneshme mund te mbidhet sa here shihet e nevojeshme prej administratorit.

Vendimet ne Asamblese merren gjithnje me shkrim dhe ne fund nenshkruhen nga palet.

#### Neni 11

Administrator i kesaj Shoqerie eshte Ortaku i vetem INA NEBIU .

#### Neni 12

Ortaku i vetem do te perfaqsoje shoqerine ne mardheniet me te tretet , do te nenshkruaje ne emer te saj te gjitha aktet qe kane te bejne me veprimatrine e shoqerise, ka te drejten e perfaqsimiit gjyqsor te kesaj shoqerie , te administroje punen e perditeshme si dhe te hape llogarine rjedhese te shoqerise duke depozituar firmen e tij .



### Neni 13

Kopetencat administrative te Ortakut te Shoqerie bazohen ne kopetencat qe me ligj i takojne asamblese se ortakeve

Ortaku miratojne statutin dhe ndryshimet ne te.

Miraton bilancin.

Zgjedh keshillin administrativ

Vendos per ndarjen e te ardhurave ,pjesemarjen ne shoseri te tjera ,shkrirjen e shoqerise parakohe,hapjen e filialeve te shoqerise ne vende te tjera si dhe per ceshtje te tjera .

### Neni 14

Ortaku dhe administratori i shoqerise mund te perfaqsohen nga persona te trete te besuar prej tyre ,gjithmone brenda kufijve ligjore dhe me prokure te leshuar sipas ligjit.

Funksionet administrative te jashtezakoneshme mund te trasferohen.

### Neni 15

Veprimtaria vjetore e shoqerise mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti .

### Neni 16

Ne perfundim te mbylljes se bilancit Asambleja e Ortakeve percakton menyren e shperndarjes se fitimit e cila do te jete ne perpjestim me kontributin ne kapitain themeltar ,likujdimin e detyrimeve dhe percaktimin e rezerves ligjore .

Si rregull rezerva ligjore nuk mund te jete me e vogel se 5% te fitimit te realizuar.

### Neni 17

Shoqeria perfundon aktivitetin e saj ne afatin e caktuar ne aktet e themelimit te saj, me perjashtim te rasteve kur ky afat zgjatet me miratim te Asamblese se Ortakeve. Ajo mund te shperndahet para afatit per arsye te parashikuara ne ligj ose nese veprimtaria e saj konsiderohet nga Asambleja si jo rentabel per nje periudhe prej dy vjetesh.

### Neni 18

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit ne momentin e prishjes se saj .

Per kryerjen e ketij procesi Asambleja do te caktojte nje ose disa likujdatore te cilet ne baze te ligjit do te paraqesin raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te shoqerise ,mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e perfundimit te tyre.

Pas pagimit te kreditorëve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates ,likuidatori ndan kapitalet e mbetura nepermejt ortakeve



proporcionalisht me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin fillestar.

Neni 19


E gjithë veprimtaria e Shoqërisë "INA" Sh.P.K do të bazohet në Ligjin N. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë Tregtare" në Ligjin Nr. 7667 datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëria tregtare" si dhe në legjislacionin në përgjithësi të R.Shqipërisë.

Neni 20

Shoqëria "INA" do të ketë vullnetin e saj.

ORTAKU I VETEM

INA NEBIU



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA

N. ~~1210~~ Rep

Vlore me 20.11.2000

V E R T E T I M

Sot me 20.11.2000 para meje noteres ALMA MUSARAJ u paraqit personalisht shtetasia INA NEBIU e datelindjes 03.03.1975 lindur dhe banuese në Vlore për identitetin e të ciles jam e sigurt nga pasaporta e saj me Nr. 1755030

Madhore me zotesi të plote për të vepruar e cila me vullnetin e saj të plote dhe në prani të noterit nënshkroi statutin e mesiperm të Shoqërisë "INA" Sh.P.K.

Une noterja e legalizoj si të rregullt ligjërish.

NOTERE  
ALMA MUSARAJ

